



Republika e Kosovës-Republika Kosova-Republic of Kosovo
Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave
Regulativni Autoritet Železnica
Railway Regulatory Authority



Në mbështetje të nenit 38(2), nenit 18 (3.1, 3.2, 3.3 dhe 3.4), nenit 94 (3.2), neni 108, 109, 110 dhe 116 të Ligjit Nr. 04/L-063 për Hekurudhat e Republikës së Kosovës, Bordi i Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave miraton:

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO	
AUTORITETI RREGULLATIV I HEKURUDHAVE	
REGULATIVNI AUTORITET ŽELEZNICA	
RAILWAY REGULATORY AUTHORITY	
DEPISEK:	NR PROT:
DEPISEK: C 1	NR PROT: 197
DEPISEK:	NR PROT:
NUMRI FAKTORE	DDMMYYYY:
NR OF STRANA	DDMMYYYY: 29/06/2018
NR OF PAGES	DDMMYYYY:
PRISHTINE / A	

Rregullore Nr.03/2018 për Ndërtim, Përmirësim, Rinovim, Vlerësim të Konformitetit dhe Autorizimin për Vendosjen në Shërbim të Mjetit Lëvizës

Neni 1 **Qëllimi**

1. Qëllimi i kësaj rregullore është që të përcaktojë kërkesat themelore për mjetet lëvizëse, mekanizmin mbikëqyrës për përputhshmërinë e tyre, si dhe procedurat për ndërtim, përmirësim, rinovim, vlerësim të konformitetit dhe vënien në shërbim të mjeteve lëvizëse.

2. Para fillimit të operimit, mjeti lëvizës duhet të jetë i autorizuar për vendosjen në shërbim.

3. Mjeti lëvizës mund të pajiset me Autorizim për Futjen në Shërbim në sistemin hekurudhor, nëse është në përputhje me kërkesat e kësaj rregullore. Mjeti i transportit hekurudhor, mund të përdoret nga një person fizik ose juridik - si pronar ose shfrytëzues i mjeteve lëvizëse që ka të drejtë për të përdorur atë.

4. Kjo rregullore nuk zbatohet për:

4.1. vagonë të regjistruar në një shtet anëtar të Bashkimit Evropian të destinuara për përdorim në një rrjet hekurudhor me një gjerësi të binarëve 1435 mm që operojnë në transportin ndërkombëtar;

4.2. mjetet e transportit hekurudhor të regjistruar në vendet e treta të destinuara për përdorim në një rrjet hekurudhor me një gjerësi të binarëve 1435 mm dhe që kanë një marrëveshje ndërkombëtare ndërmjet ARH-së dhe operatorit në fjalë, me kusht që këto mjete lëvizëse të plotësojnë kërkesat teknike të përcaktuara për mjetet e transportit hekurudhor, në masën që këto marrëveshje të jenë në përputhje me aktet ligjore të Republikës së Kosovës.

5. Para fillimit të ndërtimit të mjetit lëvizës ose përmirësimit (modifikimit, ndryshime në parametrat themelore të mjeteve lëvizëse të përcaktuara në shtojcën 1 të kësaj Rregullore modifikimin e parametrave bazë ose funksionin e tij), prodhuesit e mjeteve lëvizëse, subjekti për kryerjen e përmirësimit, ose subjekti kontraktues që urdhëron ndërtimin mjetit lëvizës i paraqet autoritetit të sigurisë (Organit të Sigurisë dhe Interoperabilitetit) së hekurudhave dokumentacionin teknik për projektin në fjalë dhe do të marrë nga kjo e fundit një vendim për kushtet e zbatueshmërisë së specifikimeve teknike për ndërveprim në përputhje me procedurat e përcaktuara në ligjet dhe rregulloret mbi ndërveprimin e sistemit hekurudhor evropian, si dhe për kushtet për vendosjen në shërbim të një lloji, serisë ose të mjeteve të transportit hekurudhor (në tekstin e mëtejshëm - lloji i mjeteve lëvizëse) në përputhje me kërkesat e kësaj Rregullore.

6. Mjetet lëvizëse të ndërtuara apo përmirësuara në përputhje me një certifikatë të konformitetit për një lloj të mjeteve lëvizëse të lëshuar nga organi i vlerësimit të konformitetit duhet të konsiderohet në përputhje me një lloj të mjeteve lëvizëse.

7. Ndërtimi ose përmirësimi i mjeteve të transportit hekurudhor duhet të kryhen në përputhje me kërkesat e përcaktuara në nenin 4 të kësaj Rregullore.

8. Kur specifikimet përkatëse teknike për interoperabilitet (ndërveprim) përfshijnë kërkesat thelbësore për mjetet lëvizëse dhe nuk parashikon asnjë përjashtim, procedurat për vlerësimin e konformitetit të parashikuara në ligjet dhe rregulloret e ndërveprimit të sistemeve hekurudhore Evropiane do të zbatohen kur të konstruktohen dhe gjatë modernizimit të mjeteve lëvizëse

konform me të gjitha specifikimet teknike për interoperabilitet (në tekstin e mëtejme – Mjeti lëvizës në përputhje me STI).

9. Vlerësimi i konformitetit për mjetet lëvizëse të cilat nuk janë në përputhje me specifikimet përkatëse teknike për interoperabilitet, duke përfshirë mjetet lëvizëse të cilat përjashtimet zbatohen dhe që, pjesërisht ose plotësisht, nuk janë në përputhje me specifikimet teknike për interoperabilitet (në tekstin e mëtejme - mjete lëvizëse që nuk janë sipas STI), do të kryhet nga një organ i njoftues i akredituar në përputhje me ligjet dhe rregulloret në lidhje me interoperabilitetin e sistemeve hekurudhore Evropiane (në tekstin e mëtejme - organi njoftues).

10. Organi njoftues duhet të vlerësojë përputhshmërinë e të gjitha parametrave bazë të mjeteve lëvizëse, siç është përcaktuar në specifikimet teknike për ndërveprim dhe në shtojcën 1 të kësaj Rregullore, me kërkesat e përcaktuara në ligjet detyrueshme dhe rregulloret, standardet, normativat dhe dokumentacionin teknik të përmendur në specifikimet teknike për ndërveprim si dhe në ligjet dhe rregulloret në lidhje me ndërveprimin e sistemeve hekurudhore Evropiane.

11. Përveç rasteve të parashikuara ndryshe në këtë Rregullore, organi njoftues duhet të kryejë vlerësimin e konformitetit të mjeteve lëvizëse në përputhje me modulet për procedurat e vlerësimit të konformitetit të përcaktuara në specifikimet teknike për ndërveprim. Kur lloji përkatës i mjeteve lëvizëse nuk i nënshtrohet asnjë specifikimeve të vlefshme teknike për ndërveprim, egzaminimi i llojit të mjeteve lëvizëse duhet të kryhet për vlerësimin e konformitetit i njësisë së mjetit lëvizës duhet të shoqërohet nga certifikata e verifikimit të njësisë së mjeteve lëvizëse.

12. Organi i Sigurisë do të autorizojë për vendosjen në shërbim të një lloji (të tipit) mjeteve lëvizëse që është ndërtuar e re, ose vendoset në treg për herë të parë (në tekstin e mëtejme - i ri), ose modernizuar, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në nenin 5 të kësaj Rregullore. Vendimi për të vendosur një lloj të mjeteve të transportit hekurudhor në shërbim duhet të hartohet, duke plotësuar dhe nënshkruar Certifikatën për Autorizimin për Vendosjen në Shërbimin një Tipi të mjeteve lëvizëse të përcaktuara në shtojcën 2 të kësaj rregullore. Vendimi do të përcaktojë kufizimet në përdorimin e mjeteve lëvizëse (p.sh, linja hekurudhore që do të përdoren dhe shpejtësitë).

13. Organi i Sigurisë do të autorizojë për vendosjen në shërbim një njësi të re ose të modernizuar të mjeteve lëvizëse që përputhet me llojin e mjetit lëvizës, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në nenin 10 të kësaj Rregullore. Vendimi për të vendosur një njësi të mjeteve lëvizëse në shërbim duhet të hartohet, duke plotësuar dhe nënshkruar Certifikatën për Autorizimin për Vendosjen në Shërbimin një njësie të mjetit lëvizës të përcaktuara në shtojcën 3 të kësaj Rregullore.

14. Kur mjeti lëvizës nuk është vendosur në tregun e Kosovës, për një mjet lëvizës të regjistruar në një shtet tjetër anëtar të Bashkimit Evropian, tipi i mjeteve lëvizëse do të jetë i autorizuar për vendosjen në shërbim, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në nenin 5 të kësaj Rregullore. Në

raste të tilla, njësitë e mjeteve lëvizëse përkatëse nuk do të autorizohen për vendosjen në shërbim.

15. Rinovimi i mjeteve lëvizëse të transportit hekurudhor duhet të kryhet në përputhje me kërkesat e përcaktuara në nenin 11 të kësaj Rregullore.

16. mjetet lëvizëse në përputhje me kërkesat e standardeve të aplikueshme ose pjesëve të tyre të cilat referenca publikohen në formën e komunikimit të Komisionit Evropian në Fletoren Zyrtare të Bashkimit Evropian (në tekstin e mëtejme - standardet e aplikueshme), do të konsiderohen në përputhje me këto kërkesa thelbësore të përmendura në këtë rregullore të cilat janë të mbuluara nga standardet e tilla.

16.1. Ministria kompetente do të informojë organin kombëtar të standardizimit në lidhje me standardet e zbatueshme të publikuara në Gazetën Zyrtare. Organi kombëtar i standardizimit do të publikojë në fagen zyrtare të tij listën e standardeve të përshtatura në statusin e standardeve kombëtare të Kosovës që mund të zbatohen për kryerjen e kërkesave të kësaj Rregullore.

17. Për vendimet e marrura nga Organi i Sigurisë në përputhje me këtë rregullore, mund të parashtrohet ankesë në gjykatë, në përputhje me procedurat e përcaktuara në Ligjin e Procedurës Administrative.

Neni 2 **Fushëveprimi**

1. Kjo Rregullore aplikohet për të gjitha mjetet lëvizëse të transportit hekurudhor siç janë:

- 1.1. Mjetet lëvizëse për transport për udhëtarë dhe mallra,
- 1.2. Mjetet lëvizëse të Mirëmbajtjes, makinat tërheqëse dhe makinave tjera lëvizëse të cilat përdorën në rrjetin e hekurudhave të Kosovës.
- 1.3. Si dhe ndonjë kombinim i të lartcekurave.

2. Kjo rregullore shërben si udhëzim për përgatitjen e një aplikacioni për marrjen e Autorizimit për Futjen në Shërbim.

3. Të gjithë ata që kanë nevojë për marrjen e autorizimit për futjen në shërbim duhet që të parashtrojnë një aplikacion në mënyrë zyrtare.

4. Operimi në hekurudhë dhe asetet e hekurudhave pa një autorizimin adekuat për futjen në shërbim do të konsiderohet i kundërligjshëm bazuar në Ligjin e Hekurudhave. Aplikuesi duhet të përmbahet kushteve përkatëse të autorizimit për futjen në shërbim si dhe kritereve tjera kur autorizimi për futjen në shërbim është lëshuar.

Neni 3

Organi Përgjegjës

1. Organi i Sigurisë Hekurudhore në kuadër të ARH-së është përgjegjës për dhënien e Autorizimit për futjen në Shërbim për të gjitha llojet e mjeteve lëvizëse hekurudhore, që përdoren në sektorin hekurudhor të Republikës së Kosovës.
2. Organi për Interoperabilitet është përgjegjës për shqyrtimin e deklaratës së konformitetit për përbërësit e interoperabilitetit dhe deklaratën e verifikimit për nënsistemin të lëshuara nga aplikuesi, të cilat duhet të përcillen me Certifikatën e konformitetit për përbërësit e Interoperabilitetit dhe Certifikatën e verifikimit për nënsistemet të lëshuara nga Organet Njoftuese të cilat dëshmojnë se përbërësit dhe nënsistemi janë në përputhje me STI.

Neni 4

Ndërtimi, Modernizimi dhe Vlerësimi i Konformitetit të Mjeteve Lëvizëse

1. Ndërtimi ose modernizimi i mjeteve të transportit hekurudhor duhet të kryhet në përputhje me zgjidhjet e parashikuara në projektin teknik, në përputhje me specifikimet teknike për ndërveprim, ligjet dhe rregulloret që rregullojnë sektorin e hekurudhave, si dhe duke marrë parasysh vendimin e Organit të Sigurisë për kushtet e aplikueshmërisë së specifikimeve teknike për ndërveprimin të përmendur në nenin 1 paragrafi 5 i kësaj Rregullore.
2. Para fillimit të ndërtimit ose modernizimit të mjeteve lëvizëse, prodhuesi, subjekti që kryen modernizimin, ose subjekti kontraktues që urdhëron ndërtimin apo përmirësimin e mjeteve lëvizëse apo përfaqësuesi i tyre i autorizuar duhet të zgjedhin organin njoftues, i cili kryen vlerësimin e konformitetit në lidhje me ndërtimin apo përmirësimin e mjeteve të tilla lëvizëse.
3. Organi njoftues, i cili është zgjedhur për vlerësimin e konformitetit në lidhje me ndërtimin apo përmirësimin e mjeteve lëvizëse, fillon punën e tij që në fazën e projektimit dhe do të vazhdojë me punën e tij gjatë gjithë fazës së ndërtimit ose përmirësimit, deri në vendosjen e mjetit lëvizëse në shërbim.
4. Organi njoftues, i cili është zgjedhur për vlerësimin e konformitetit në lidhje me ndërtimin apo përmirësimin e mjeteve lëvizëse, do të kryejë vlerësimin në fazat e mëposhtme:
 - 4.1. dizajnimi i ndërtimit ose modernizimi i mjeteve lëvizëse;
 - 4.2. ndërtimin ose modernizimi i mjeteve lëvizëse;
 - 4.3. testimin final të mjetit lëvizës, para vendosjes së saj në shërbim.
5. Organi njoftues duhet të vlerësojë përputhshmërinë e projektimit dhe të dokumentacionit teknik për ndërtimin apo modernizimin e mjeteve lëvizëse me kërkesat e specifikimeve teknike për ndërveprim, ligjeve dhe rregullave të detyrueshme, standardeve, normave dhe dokumentacionit teknik, si dhe përputhshmëria e një mostër të re-ndërtuar ose modernizuar të mjeteve lëvizëse me dizajnin dhe dokumentacionin teknik. Ku mjetet lëvizëse përputhen me kërkesat teknike, organi i njoftues do të lëshojë një certifikatë të konformitetit në lidhje me tipin e mjeteve lëvizëse. Në rast të mos-konformitetit, organi i njoftues refuzon të lëshojë certifikatën e konformitetit, duke i dhënë

arsyet për vendimin e tij, si dhe do të informojë Organin e Sigurisë hekurudhore që një vendim i tillë është marrë.

5.1. Nëse konformiteti i mjeteve lëvizëse me kërkesat e ligjeve, rregulloreve, standardeve, dokumenteve normative dhe teknike, të cilat janë aplikuar në plotësimin e kërkesave të kësaj Rregullore në Kosovë, nuk është certifikuar me një certifikatë të konformitetit për tipin e mjeteve lëvizëse të lëshuar nga organi i akredituar i një shteti anëtar i Bashkimit Evropian. Organi i njoftues i lartpërmendur në nenin 1 paragrafi 9 i kësaj Rregullore do të vërtetojë konformitetin e tipit të mjeteve lëvizëse me infrastrukturën që do të përdoret dhe kërkesat e ligjet e tilla dhe rregulloret, standardet dhe dokumentacioni normativ dhe teknik në përputhje me procedurat e përcaktuara në nenin 4 paragrafi 5.3 të kësaj Rregullore.

5.2. Nëse mjeti lëvizës është ndërtuar jashtë Bashkimit Evropian dhe certifikata e konformitetit të tipit është lëshuar nga Autoriteti i Vlerësimit të Konformitetit të shtetit palë kontraktuese të Organizatës për Bashkëpunim në mes të Hekurudhave, organi i njoftues i lartpërmendur në nenin 1 paragrafi 9 i kësaj Rregullore do të vërtetojë konformitetin e tipit të mjeteve lëvizëse me infrastrukturën që do të përdoren dhe kërkesat e ligjeve, rregulloreve, standardeve dhe dokumenteve normative dhe teknike në përputhje me procedurat e përcaktuara në nenin 4 paragrafi 5.3 i kësaj rregullore, të cilat janë aplikuar në plotësimin e kërkesave të kësaj Rregullore në Kosovë.

5.3. Një pronar ose shfrytëzues i mjeteve lëvizëse që dëshiron që të vendos në shërbim llojet e mjeteve të transportit hekurudhor të lartë cekura në nenin 4 paragrafët 5.1 dhe 5.2 të kësaj Rregullore, duhet ti ofrojë organit njoftues qasje në dokumentacionin e mjeteve lëvizëse përkatëse në mënyrë që të jenë në gjendje për të përcaktuar me saktësi origjinën e mjeteve lëvizëse dhe konformitetin me infrastrukturën që do të përdoret dhe kërkesat e ligjeve, rregulloreve, standardeve dhe dokumenteve normative dhe teknike, të cilat aplikohen në plotësimin e kërkesave të kësaj Rregullore në Kosovë. Organi i akredituar duhet të kryejë vlerësimin në bazë të dokumentacionit në dispozicion. Nëse dokumentacioni i ofruar nuk është i mjaftueshem për lëshimin e një certifikate, organi i akredituar në marrëveshje me pronarin apo shfrytëzuesin e mjeteve lëvizëse do të shqyrtojë përputhshmërinë e njësisë së tipit të mjetit lëvizës, duke përdorur metodat e testeve jo-destruktive.

6. Kur ndërtimi apo modernizimi i një numri të njësive identike mjeteve lëvizëse është kryer në përputhje me një certifikatë të konformitetit për llojin (tipin) e mjeteve të transportit hekurudhor të përmendur në nenin 4 paragrafi 5 të kësaj Rregullore, organi i akredituar duhet të vlerësojë përputhshmërinë e çdo njësie të mjeteve lëvizëse me kushtet e certifikatës së konformitetit për llojin e mjeteve lëvizëse. Në një rast të tillë, prodhuesi i mjeteve lëvizëse, njësia për kryerjen e modernizimit, ose subjekti kontraktues që ka urdhëruar ndërtimin e një mjeti lëvizës të këtillë nuk do të kërkojë në mënyrë të përsëritur vendimin e përmendur në nenin 1 paragrafi 5 i kësaj rregullore nga Organi i Sigurisë.

6.1 Në qoftë se një njësi e mjetit lëvizës është ndërtuar nga një Kontraktues jashtë Bashkimit Evropian dhe në përputhje me llojin e mjeteve lëvizëse të vlerësuar në përputhje me nenin 4 paragrafi 5.2 i kësaj Rregullore, organi i akredituar i përmendur në nenin 1 paragrafi 9 i kësaj Rregullore do të vërtetojë konformitetin e njësive se mjetit lëvizës me llojin e mjeteve lëvizëse, duke kontrolluar vetëm kërkesat që janë vlerësuar në kryerjen e certifikimit të përmendur në nenin 4 paragrafi 5.3 i kësaj Rregullore.

7. Modernizimi i mjeteve lëvizëse duhet të shoqërohet me rinovimin deri në masën e nevojshme për të siguruar që edhe nënsistemet e mjeteve lëvizëse dhe komponentët nuk i nënshtrohen një modernizimi të tillë dhe mbeten funksionale.

Neni 5

Autorizimi për Vendosjen në Shërbimin të një Tipi (Lloji) të Mjetit Lëvizës Kërkesat e Përgjithshme

1. Lloji i mjetit lëvizës mund të vendoset në shërbim, kur:

1.1. Dokumentacioni teknik (Shtojca 4) është përgatitur në lidhje me llojin (Tipin) e mjeteve lëvizëse që përshkruan strukturën dhe karakteristikat teknike të mjeteve lëvizëse përkatëse, si dhe ka një program për mirëmbajtjen dhe riparimin e tyre. Dokumentacioni teknik duhet të përfshijë një përshkrim të të gjitha parametrave bazë të mjeteve lëvizëse të përmendura në specifikimet teknike për ndërveprim ose në shtojcën 1 të kësaj Rregullore;

1.2. mjetet lëvizëse janë në përputhje me ligjet dhe rregulloret që rregullojnë funksionimin teknik të hekurudhave;

1.3. mjetet lëvizëse janë në përputhje me një zgjidhje të veçantë të projektimit;

1.4. mjetet lëvizëse janë në përputhje me sistemin e furnizimit me energji, kontrollit komandës dhe sistemit të sinjalizimit, gjerësinë e binarëve si dhe ngarkesën boshtore maksimale të lejuar të infrastrukturës hekurudhore të vendit të caktuar të operimit;

1.5. vlerësimi i konformitetit të tipit të mjetit lëvizës është kryer, duke përfshirë kontrollet dhe testet.

2. Pronari, përdoruesi, prodhuesi i mjeteve lëvizëse, njësia e mirëmbajtjes për kryerjen e modernizimit, subjekti kontraktues apo përfaqësuesi i tyre i autorizuar (në tekstin e mëtejshëm - aplikanti) do të kërkojë nga menaxheri i infrastrukturës hekurudhore që të shqyrtojë kompatibilitetin e mjetit lëvizës me infrastrukturën në të cilën përdoret.

2.1 Pas testeve të kërkuara për mjetet lëvizëse të lartcekura në nenin 5 paragrafin 2 i kësaj Rregullore, parashtuesi i kërkesës duhet të dorëzojë dokumentacionin teknik të lartpërmendur në nenin 5 paragrafi 1.1 të kësaj Rregullore të menaxheri përkatës i infrastrukturës. Menaxheri i infrastrukturës mund të kërkojë informacion shtesë i cili është i nevojshëm për kryerjen e testeve dhe përpilimin e rezultateve.

3. Menaxheri i infrastrukturës, në bazë të dokumentacionit teknik të paraqitur dhe rezultatet e testit të vozitjes, do të verifikojë kompatibilitetin teknik të tipit të mjetit lëvizës me infrastrukturën hekurudhore në të cilin ai është inkorporuar. Brenda fushës së verifikimit aplikanti mund të kryej disa teste të vozitjes në marrëveshje me menaxherin e infrastrukturës.

3.1 Pas kryerjes së një testi të vozitjes, menaxheri i infrastrukturës duhet të kontrollojë funksionimin e frenimit të mjeteve lëvizëse, funksionimin e pajisjeve të sigurisë dhe të komunikimit, bashkëveprimin e pjesëve të mjetit lëvizës me rrugën hekurudhore, implementimi i fuqisë së tërheqjes dhe kohës së lëvizjes, si dhe si ndikimin e mjeteve lëvizëse në pajisjet e infrastrukturës hekurudhore të veçantë dhe pajtueshmërinë me pajisje të furnizimit me energji

elektrike të një infrastrukture të tillë. Menaxheri i infrastrukturës do të regjistrojë rezultatet e testit në raportin e testit të vozitjes (Shtojca 7).

3.2 Menaxheri i infrastrukturës mund të mos kryejë një test të vozitjes për një lloj të vagonëve të mallrave të parashikuar për një rrjet hekurudhor me gjerësi të binarëve 1435 milimetër, nëse dokumentacioni teknik i llojit të tillë përmban informacion të mjaftueshëm në lidhje me mënyrat e frenimit të mjeteve lëvizëse, komunikimin, bashkëveprimin e vagonit me binaret hekurudhor dhe pajisjet e tjera të infrastrukturës hekurudhore.

4. Brenda tre muajve nga marrja e kërkesës nga aplikuesi, menaxheri i infrastrukturës, në marrëveshje me aplikuesin duhet të sigurojnë kryerjen e testeve dhe të sjellin rezultatet e testeve.

5. Në përputhje me testet e lartpërmendur në nenin 5 paragrafi 3.1 të kësaj Rregullore menaxheri i infrastrukturës duhet të tregojë rezultatet e testimit, të dhënat në lidhje me kompatibilitetin teknike të tipit të mjeteve të transportit hekurudhor me infrastrukturën, në të cilin ai është futur, dhe seksionet e infrastrukturës hekurudhore, ku mund të përdoret mjeti lëvizës, si dhe kushtet dhe kufizimet (nëse ka) duhet të merren parasysh në mënyrë që lloji i mjetit lëvizës do të jetë teknikisht në përputhje me infrastrukturën në të cilin ai është bashkuar. Një raport i testit të vozitjes (nëse është kryer), i bashkëngjitet rezultateve të testit.

6. Një STI-konform llojit (tipit) të mjeteve lëvizëse duhet autorizohet për vendosjen në shërbim, në përputhje me dispozitat e kësaj Rregullore.

7. Një STI-jo konform llojit (tipit) të mjeteve lëvizëse duhet të jetë i autorizuar për vendosjen në shërbim, në përputhje me dispozitat e kësaj Rregullore.

8. Për llojin (tipin) e mjeteve lëvizëse të autorizuara për vendosjen në shërbim, aplikanti do të dorëzojë një kërkesë te Organi i Sigurisë, bashkëngjitur në vijim të saj:

8.1. deklaratën në përputhje me Rregulloren e Komisionit (BE) Nr. 201/2011/EU dhe Rregullorës së ARH Nr. 01/2014 për modelin e deklaratës së konformitetit për një lloj të autorizuar të mjetit hekurudhor me shtojcat, të cilat janë përcaktuar për rastin përkatës të vendosjes në shërbim në nenin 6 paragrafi 2, neni 7 paragrafi 4, neni 8 paragrafi 1, 2, dhe neni 9 paragrafi 2 ose 3 të kësaj rregullore;

8.2. dokumentacionin teknik të përmendur në shtojcën 4 të kësaj rregullore;

8.3. rezultatet e testit të menaxherit të infrastrukturës hekurudhore të lartpërmendur në nenin 5 paragrafin 2 të kësaj Rregullore në lidhje me kompatibilitetin teknike të tipit të mjeteve lëvizëse me infrastrukturën në të cilin ai është bashkuar (inkorporuar).

9. Organi i Sigurisë vendos për autorizimin për vendosjen në shërbim të një lloji të mjetit të transportit konform STI (tipit) të mjeteve të transportit hekurudhor në përputhje me procedurat e përcaktuara në Ligjin hekurudhave të Kosovës pas kompletimit të dokumentacionit të aplikimit.

Neni 6

Autorizimi për Vendosjen në Shërbim të Mjetit Lëvizës Konform-STI, i cili nuk ka qenë më parë i Autorizuar për Vendosje në Shërbimin në Shtetet anëtare të Bashkimit Evropian.

1. dispozitat e këtij neni do të zbatohen të Mjetet lëvizëse konform STI, të cilat nuk kanë qenë më parë të autorizuar për vendosjen në shërbim në një shtet tjetër anëtar të Bashkimit Evropian dhe në pajtueshmëri me të gjitha specifikimet përkatëse teknike për ndërveprim në fuqi në ditën kur lloji i mjeteve të transportit hekurudhor është i autorizuar për vendosjen në shërbim.

2. deklarimi i aplikuesit të Organi i Sigurisë hekurudhore të referuara në nenin 5 dhe nënparagrafin 8.1 të kësaj Rregullore, duhet që me rastin e deklarimit të saj, të bashkëngjiten shtojcat vijuese:

2.1. dokumentacionin teknik, në përputhje me ligjet dhe rregulloret mbi ndërveprimin e sistemeve hekurudhore Evropiane;

2.2. deklaratat e konformitetit në lidhje me mjetet lëvizëse dhe nënsistemet e saj, në pajtim me ligjet dhe rregulloret mbi ndërveprimin e sistemeve hekurudhore Evropiane;

2.3. certifikata e vlerësimit të konformitetit të lëshuara nga organi i autorizuar, së bashku me dëshmi relevante;

2.4. deklaratat e konformitetit dhe dëshmi për karakteristikat teknike dhe operacionale që tregojnë se mjeti lëvizës është në përputhje me infrastrukturën dhe instalimet fikse, duke përfshirë kushtet klimatike, sistemit të furnizimit me energji, e kontrollit të komandës dhe sistemit të sinjalizimit, gjerësia e binareve dhe të infrastrukturës, ngarkesës maksimale boshtore të lejuar dhe kufizimet e tjera të infrastrukturës hekurudhore;

2.5. mjeti lëvizës i ndërtuar për infrastrukturën hekurudhore 1435 mm-gjerësi ka për qëllim gjithashtu të përdoret për transportin për në dhe nga vendet e treta, duhet të ofrohen dëshmi për plotësimin e kërkesave të vendeve të treta ku mendohet të operohet.

3. Organi i Sigurisë hekurudhore do të vendosë për autorizimin e një lloji të mjeteve lëvizëse për vendosjen në shërbim, sipas procedurave të mëposhtme:

3.1. ku të gjitha nënsistemet strukturore të mjeteve të transportit hekurudhor janë autorizuar për vendosjen në shërbim, në përputhje me ligjet dhe rregulloret për ndërveprimin e sistemeve hekurudhore Evropiane, vendimi për autorizimin e një lloji (tipi) të mjeteve lëvizëse për vendosjen në shërbim duhet të merret pa testet e mëtejshme;

3.2. ku të gjitha deklaratat e verifikimit të lëshuara nga shtetet anëtare të BE, siç parashikohet në ligjet dhe rregulloret për ndërveprimin e sistemeve hekurudhore Evropiane, janë lëshuar për mjetet lëvizëse, Organi i Sigurisë dhe Interoperabilitetit duhet, që për qëllime të marrjes së vendimit, të shqyrtojë si në vijim:

3.2.1. ndërveprimin të nënsistemeve përkatëse të mjeteve lëvizëse;

3.2.2. futja e sigurt e mjeteve lëvizëse në sistemin e menaxhimit të sigurisë të përdoruesit, në përputhje me Rregulloren e Implementimit të Komisionit Evropian (BE) Nr 402/2013/EU për

metodën e përbashkët të sigurisë për vlerësimin e rrezikut dhe vlerësimin dhe shfuqizimin e Rregullores Nr. 352/2009/EU.

3.2.3. përputhshmëria teknike e mjeteve lëvizëse me infrastrukturën përkatëse hekurudhore;

3.2.4. kur specifikimet teknike për ndërveprim të ofrojnë prova për pika të hapura të nevojshme për të siguruar pajtueshmërinë me kërkesat themelore, dëshmi e lëshuar nga organi i akredituar për përputhje me dokumentacionin e zbatueshëm për raste të tilla;

3.2.5. dëshmi e lëshuar nga organi i akredituar për përputhje me dispozitat e ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në raste të veçanta, siç parashikohet në specifikimet përkatëse teknike për ndërveprim.

4. Me qëllim që të shqyrtohen kriteret të përmendura në nenin 6 dhe nën-paragrafin 3.2 të kësaj Rregullore, Organi i Sigurisë mund të kërkojë informacion shtesë për analizën e rrezikut në përputhje me Rregulloren Nr 402/2013/EU ose për testet e kryera në infrastrukturën përkatëse hekurudhore. Organi i Sigurisë do të specifikojë, pas konsultimeve me aplikuesit, qëllimin dhe përmbajtjen e informacionit shtesë, analizën e rrezikut dhe testet e kërkuar.

Neni 7

Autorizimi për Vendosjen në Shërbim të Mjetit Lëvizës Konform-STI, i cili ka qenë i Autorizuar për Vendosjen në Shërbimin në shtetet e tjera anëtare të Bashkimit Evropian

1. Dispozitat e këtij neni do të zbatohen për mjetet lëvizëse konform STI i cili është i autorizuar për vendosjen në shërbim në një shtet tjetër anëtar të Bashkimit Evropian dhe është në përputhje me të gjitha STI-të përkatëse në fuqi në ditën që tipi i mjeteve lëvizëse të transportit hekurudhor është i autorizuar për vendosjen në shërbim.

2. Kur mjeti lëvizës konform STI ka qenë i autorizuar për vendosjen në shërbim në një shtet tjetër anëtar të Bashkimit Evropian, procedura e përcaktuar në nenin 7 paragrafët 4, 5 dhe 6 të kësaj Rregullore do të zbatohet për autorizimin për vendosjen në shërbim të llojit të mjetit lëvizës në Kosovë, me përjashtim të STI të përmendur në nenin 7 paragrafi 3 i kësaj Rregullore.

3. Kur mjeti lëvizës konform STI, ka qenë i autorizuar për vendosjen në shërbim në një shtet tjetër anëtar të Bashkimit Evropian, si dhe do të operojë vetëm në infrastrukturën që plotësisht përputhet me specifikimet teknike për ndërveprim për mjetet e tilla lëvizëse nuk kërkohet autorizimi i mëtejshëm i llojit (tipit) të mjeteve lëvizëse për vendosjen në shërbim në Kosovë. Në një rast të tillë, pronari ose shfrytëzuesi i mjeteve lëvizëse duhet, para se të vënë mjetet lëvizëse në shërbim, të paraqesë të Organi i Sigurisë informacionin që identifikon mjetet lëvizëse dhe tregon vendin ku lloji i mjeteve të transportit hekurudhor ka qenë i autorizuar për vendosjen në shërbim.

4. Deklarata e aplikantit për të Organi i Sigurisë hekurudhore i përmendur në nenin 5 dhe nën-paragrafin 8.1 të kësaj Rregullore, duhet që aplikacioni të shoqërohet me shtojcat vijuese:

4.1. dëshmi të dokumentuara se operimi konform STI i llojit (tipit) të mjetit lëvizës ka qenë i autorizuar në një shtet tjetër anëtar të Bashkimit Evropian;

4.2. deklaratimet e konformitetit dhe dokumentacionin teknik në përputhje me ligjet dhe rregulloret mbi ndërveprimin e sistemeve hekurudhore Evropiane. Ku mjeti lëvizës është pajisur me regjistruar e të dhënave, që do të përfshijë informacionin mbi procedurën e mbledhjes së të

dhënave, e cila lejon për të lexuar dhe për të vlerësuar të dhëna të tilla, në rast se mbledhja e të dhënave të tilla nuk është në përputhje me specifikimet përkatëse teknike për ndërveprim;

4.3. të dhënat tregojnë historinë e operimit të mjeteve lëvizëse, mirëmbajtjen dhe modifikimet teknike të ndërmarra pas autorizimit për vendosjen në shërbim në një shtet tjetër anëtar të Bashkimit Evropian;

4.4. deklaratimet e konformitetit dhe dëshmi për karakteristikat teknike dhe operacionale që tregojnë se mjeti lëvizës është në përputhje me infrastrukturën dhe instalimet fikse, duke përfshirë kushtet klimatike, sistemit të furnizimit me energji, e kontrollit të komandës dhe sistemit të sinjalizimit, gjerësinë e binareve, ngarkesën maksimale boshtore të lejuar në infrastrukturë;

4.5. kur mjeti lëvizës është i ndërtuar për infrastrukturën hekurudhore 1435-mm-gjerësi dhe ka gjithashtu për qëllim të përdoret për transportin për në dhe nga vendet e treta, të ketë dëshmi për plotësimin e kërkesave të këtyre vendeve.

5. Organi i Sigurisë duhet të shqyrtojë;

5.1. pajtueshmërinë teknike në mes të mjeteve lëvizëse dhe të infrastrukturës përkatëse. Kur specifikimet teknike për ndërveprim të sigurojnë për pika të hapura të nevojshme për të siguruar pajtueshmërinë me kërkesat themelore, gjithashtu dëshmia e lëshuar nga organi njoftues mbi konformitetin me dokumentacionin e zbatueshëm, në raste të tilla duhet të kërkojnë edhe;

5.2. dëshmi të lëshuar nga organi njoftues për përputhshmërinë me dispozitat e ligjore dhe rregulloret në fuqi të aplikueshme për raste të veçanta, siç parashikohet në specifikimet përkatëse teknike për ndërveprim.

6. Me qëllim që të shqyrtohen kriteret e përmendura në nenin 7 paragrafi 5 të kësaj Rregullore, Organi i Sigurisë mund të kërkojë informacion shtesë për analizën e rrezikut në përputhje me Rregullorën Nr. 402/2013/EU ose në testet e kryera në lidhje me infrastrukturën përkatëse hekurudhore. Organi i Sigurisë do të përcaktojë, pas konsultimeve me aplikantin, qëllimin dhe përmbajtjen e informacionit shtesë, analizën e rrezikut dhe testet e kërkuara. Organi i Sigurisë mund të shqyrtojë vetëm konformitetin me grupin B dhe kërkesat teknike C e përmendur në paragrafët 17 dhe 18 të Shtojcës 1 të kësaj Rregullore.

Neni 8

Autorizimi për Vendosjen në Shërbim të Mjetit Lëvizës Jo-Konform-STI, i cili nuk ka qenë më parë i Autorizuar për Vendosje në Shërbimin në Shtetet e tjera Anëtare të Bashkimit Evropian.

1. Me qëllim të Autorizimit të mjetit lëvizës apo llojin (tipin) e mjetit lëvizës, jo-konform-STI për vendosjen në shërbim, me përjashtim të vagonëve e përmendur në nenin 8 paragrafin 2 të kësaj Rregullore, deklarata e aplikantit të Organi i Sigurisë hekurudhore e përmendur në nenin 5 nën - paragrafin 8.1 të kësaj Rregullore, duhet që me aplikacionin e saj, të shoqërohet me shtojcat vijuese:

1.1. deklaratimet e konformitetit dhe dokumentacionin teknik në përputhje me ligjet dhe rregulloret mbi ndërveprimin e sistemeve hekurudhore Evropiane, ku specifikimet teknike për ndërveprimin janë aplikuar në lidhje me secilin parametër teknik të mjeteve lëvizëse;

1.2. deklaratat e konformitetit dhe dëshmi të lëshuar nga organi njoftues mbi konformitetin e karakteristikave teknike dhe operacionale me dispozitat e aplikueshme të ligjeve dhe rregulloreve;

1.3. deklaratat e konformitetit dhe dëshmi mbi karakteristikat teknike dhe operacionale që tregojnë se mjeti lëvizës është në përputhje me infrastrukturën dhe instalimet fikse, duke përfshirë kushtet klimatike, sistemit të furnizimit me energji, e kontrollit të komandës dhe sistemit të sinjalizimit, gjerësinë e binareve, ngarkesën maksimale boshtore të lejuar në infrastrukturë dhe kufizimet e tjera të infrastrukturës hekurudhore;

1.4. kur mjeti lëvizës është i ndërtuar për infrastrukturën hekurudhore 1435-mm-gjerësi dhe ka për qëllim që të përdoret gjithashtu për transportin për në dhe nga vendet e treta, të ofroje dëshmi mbi plotësimin e kërkesave të vendeve të treta.

2. Me qëllim të autorizimit për vendosjen në shërbim një tipi (lloji) të vagonit i ndërtuar për rjetin hekurudhor 1435-mm-gjerësi, të destinuar për përdorim në territorin e Kosovës për transportin ndërkombëtar në dhe nga vendet e treta, deklarata e aplikantit për Organin e Sigurisë hekurudhore e përmendur në nenin 5 nën-paragrafin 8.1 të kësaj Rregullore, duhet që së bashku me aplikacionin të shoqërohet me shtojcat vijuese:

2.1. dëshmi të dokumentuara se operimi i llojit të vagonit ka qenë i autorizuar në vendet e treta;

2.2. deklaratat e konformitetit dhe provat mbi pajtueshmërinë teknike të mjeteve lëvizëse me infrastrukturën përkatëse hekurudhore.

3. Organi i Sigurisë hekurudhore vendos për autorizimin e një lloji (tipi) të mjetit lëvizës jo-konform-STI për vendosjen në shërbim, sipas procedurës së mëposhtme:

3.1. ku deklaratat e verifikimit, siç parashikohet në ligjet dhe rregulloret mbi ndërveprimin e sistemeve hekurudhore Evropiane, janë hartuar duke u bazuar në disa parametra teknike të mjeteve lëvizëse, për të cilat janë aplikuar specifikimet teknike për interoperabilitet, për procedurën e përcaktuar në nenin 6 nën-paragrafin 3.2 të kësaj Rregullore do të zbatohen parametra të tilla;

3.2. në lidhje me parametrat tjera teknike dhe mjeteve të transportit hekurudhor si tërësi, duhet të shqyrtohen si më poshtë :

3.2.1. konformiteti teknik i mjeteve lëvizëse me dispozitat e ligjeve dhe rregulloreve në fuqi;

3.2.2. pajtueshmërinë teknike në mes të mjeteve lëvizëse dhe të infrastrukturës përkatëse;

3.2.3. integrimin e sigurt të mjeteve lëvizëse në sistemin e menaxhimit të sigurisë të përdoruesit në përputhje me dispozitat e Rregullores Nr. 402/2013/EU;

3.2.4. procedurat për operim, riparime dhe mirëmbajtje të mjeteve lëvizëse.

4. Me qëllim që të shqyrtohen kriteret e përmendura në nenin 8 paragrafin 3 të kësaj Rregullore, Organi i Sigurisë hekurudhore mund të kërkojë informacion shtesë mbi analizën e rrezikut në përputhje me Rregulloren Nr. 402/2013/EU për testet e kryera në infrastrukturën përkatëse

hekurudhore. Organi i Sigurisë hekurudhore do të përcaktojë, pas konsultimeve me aplikantin, qëllimin dhe përmbajtjen e informacionit shtesë, analizën e rrezikut dhe testet e kërkuara.

Neni 9

Autorizimi për Vendosjen në Shërbim të Mjetit Lëvizës Jo-Konform-STI, i Cili ka Qenë më parë i Autorizuar për Vendosje në Shërbimin në Shtetet e tjera Anëtare të Bashkimit Evropian.

1. Organi i Sigurisë hekurudhore, në rast se merr një vendim në përputhje me dispozitat e këtij neni, të marrë parasysh vendimin e një shteti tjetër anëtar të Bashkimit Evropian mbi autorizimin e mjeteve lëvizëse jo-konform-STI për vendosjen në shërbim.

2. Me qëllim të autorizimit të një lloji (tipi) të mjetit lëvizës jo-konform-STI për vendosjen në shërbim, përveç vagonëve të përmendur në nenin 9 paragrafi 3 të kësaj Rregullore, deklarata e aplikantit të Organi i Sigurisë hekurudhore i përmendur në nenin 5 nën-paragrafin 8.1 të kësaj Rregullore, duhet që aplikacionin e saj ta shoqërojë me shtojcat vijuese:

2.1. dëshmi të dokumentuara që operimi i një lloji (tipi) të mjeteve lëvizëse ka qenë i autorizuar në një Shtet Anëtar dhe dokumentacionin për procedurën e ndjekur në mënyrë që të tregojnë se lloji i mjeteve të transportit hekurudhor është në përputhje me kërkesat e efektive të sigurisë në vendin përkatës, si dhe informacione për shmangiet (derogimet) e zbatuara;

2.2. karakteristikat teknike, programi i mirëmbajtjes dhe karakteristikat operative, ku mjete lëvizës është e pajisur me regjistruar të të dhënave - çdo informacion mbi procedurën e mbledhjes së të dhënave, e cila lejon për të lexuar ato dhe vlerësuar;

2.3. të dhënat që tregojnë historinë e operimit të mjetit lëvizës, mirëmbajtjen dhe modifikimet teknike të ndërmarra pas autorizimit për vendosjen në shërbim në shtetin tjetër anëtar të Bashkimit Evropian;

2.4. deklaratat e konformitetit dhe dëshmi mbi karakteristikat teknike dhe operationale që tregojnë se mjete lëvizës është në përputhje me infrastrukturën dhe instalimet fikse, duke përfshirë kushtet klimatike, sistemit të furnizimit me energji, e kontrollit të komandës dhe sistemit të sinjalizimit, gjerësinë e binareve, ngarkesën maksimale boshtore të lejuar si dhe kufizimet e tjera të infrastrukturës hekurudhore;

2.5. kur mjete lëvizës i ndërtuar për infrastrukturën hekurudhore 1435-mm-gjerësi ka për qëllim që gjithashtu të përdoret për transportin për në Kosovë dhe nga vendet e treta, duhet të ofroj dëshmi mbi plotësimin e kërkesave të vendeve të treta.

3. Me qëllim autorizimit për vendosjen në shërbim të një tipi të vagonit i ndërtuar për rrjetin hekurudhor 1435-mm-gjerësi, nëse llojet (tipet) e tilla janë të destinuara për përdorim në territorin e Kosovës për transportin ndërkombëtar për dhe nga vendet e treta, nga deklarata e aplikantit të Organi i Sigurisë hekurudhore i përmendur në nenin 5 nën-paragrafin 8.1 të kësaj Rregullore, duhet që aplikacionin e saj ta shoqërojë me shtojcat vijuese:

3.1. dëshmi të dokumentuara që operimi i llojit (tipit) të vagonit ka qenë i autorizuar në një shtet tjetër anëtar të Bashkimit Evropian;

3.2. dëshmi të dokumentuara që operimi i llojit (tipit) të vagonit ka qenë i autorizuar në vendet e treta;

3.3. deklaratat e konformitetit dhe dëshmi për karakteristikat teknike dhe operacionale që tregojnë se mjeti lëvizës është në përputhje me infrastrukturën dhe instalimet fikse, duke përfshirë kushtet klimatike, sistemit të furnizimit me energji, e kontrollit të komandës dhe sistemit të sinjalizimit, gjerësinë e binareve, ngarkesën maksimale të lejuar boshtore dhe kufizimet e tjera të infrastrukturës hekurudhore;

4. Organi i Sigurisë hekurudhore nuk do të shqyrtojë përputhshmërinë e dokumenteve të përmendura në nenin 9 nën-paragrafët 2.1, 2.2, 3.1 dhe 3.2 të kësaj Rregullore, përveç nëse ka dëshmi mbi rreziqet materiale për sigurinë. Nëse Organi i Sigurisë hekurudhore do të shqyrtojë përputhshmërinë e dokumenteve të sipërpërmendura në nenin 9 nën-paragrafët 2.1, 2.2, 3.1 dhe 3.2 të kësaj Rregullore, nuk mund t'i referohet grupit kërkesave teknike A e përmendur në paragrafin 16 të shtojcës 1 të kësaj Rregullore.

5. Me qëllim që të shqyrtohen kriteret të përmendura në nenin 9 nën-paragrafët 2.3, 2.4, 2.5 dhe 3.3 të kësaj Rregullore, Organi i Sigurisë hekurudhore mund të kërkojë informacion shtesë në analizën e rrezikut në përputhje me Rregulloren Nr. 402/2013/EU ose për testet e kryera në infrastrukturën përkatëse hekurudhore. Organi i Sigurisë hekurudhore do të përcaktojë, pas konsultimeve me aplikantin, qëllimin dhe përmbajtjen e informacionit të tillë shtesë, analizën e rrezikut dhe testet e kërkuara. Organi i Sigurisë hekurudhore mund të shqyrtojë vetëm konformitetin me grupin B dhe kërkesat teknike C të përmendura në paragrafët 17 dhe 18 të Shtojcës 1 të kësaj Rregullore.

Neni 10

Autorizimi për Vendosjen në Shërbim të Njësive të Mjeteve Lëvizëse të Reja ose të Modernizuara

1. Një njësi e mjeteve lëvizëse mund të vendoset në shërbim, kur:

1.1. lloji i mjetit lëvizës ka qenë i autorizuar për vendosjen në shërbim, në përputhje me nenin 5 të kësaj Rregullore;

1.2. deklaratat e konformitetit që kërkojnë të vlerësohet konformiteti i certifikatave që janë lëshuar për njësinë e mjeteve lëvizëse ;

1.3. vozitjet testuese që janë bërë në lidhje me njësinë e mjeteve lëvizëse në përputhje me procedurën e përcaktuar në këtë nen;

1.4. njësia e mjetit lëvizës është në gjendje të mirë teknike;

1.5. një njësi përgjegjëse për mirëmbajtjen teknike të përmendura në ligjet dhe rregulloret për kriteret dhe procedurat për lëshimin, pezullimin dhe revokimin e certifikatës së sigurisë, përkatësisht subjekti përgjegjës për mirëmbajtjen e mjeteve lëvizëse është i regjistruar në regjistrin Nacional të mjeteve lëvizëse, është caktuar për mirëmbajtjen e njësive të mjeteve lëvizëse.

2. Mjeti lëvizës tërheqës dhe vagonët e udhëtarëve duhet të nënshtrohen testeve si më poshtë:

2.1. kur mjeti lëvizës tërheqës ka për qëllim që të përdoret në infrastrukturën e përdorur publike jo më pak se 40 km me jo-ngarkesës pune dhe jo më pak se 40 km me ngarkesë të punës do të kryhet gjatë testimit të mjetit lëvizës;

2.2. kur mjeti lëvizës tërheqës nuk ka për qëllim përdorimin në infrastrukturën e përdorur publike, teste e tilla për këto mjete lëvizëse duhet të kryhen vetëm në infrastrukturën për përdorim privat;

2.3. gjatë testimit duhet të arrihet shpejtësia maksimale e lejuar dhe jo më pak se 40 km/h do të kryhet gjatë testit provues të mjeteve lëvizëse për makinat lëvizëse me energji elektrike të destinuara për transportin e udhëtarëve dhe vagon të udhëtarëve.

3. Asnjë test provues nuk duhet të kryhet për vagonët e mallrave.

4. Një protokoll duhet të hartohet për çdo test provues, në përputhje me modelin e përcaktuar në Shtojcën 5 të kësaj Rregullore; protokollin duhet të nënshkruhet.

5. Kur një test provues është kryer për mjetet lëvizëse tërheqëse të përbërë nga më shumë se një njësi, protokollin përkatës duhet të hartohet për çdo njësi të mjetit lëvizës veç e veç.

6. Kur gjatë një testi provues të mjetit lëvizës tërheqës ose një vagoni të udhëtarëve, mangësitë e ndërruesit të shpejtësisë, njësisë së energjisë, pajisjeve të frenimit apo pajisje të sigurisë së trafikut janë gjetur, një protokoll për korrigjimin e mangësive të tilla duhet të hartohet pas korrigjimit të mangësive të tilla. Protokollin i tillë duhet të nënshkruhet nga të njëjtët persona të cilët kanë nënshkruar protokollin për testin provues të përmendur në nenin 10 paragrafi 4 të kësaj Rregullore.

7. Kur gjatë një testi provues të një mjeti lëvizës tërheqës ose defektet në një vagon të udhëtarëve apo të metat e një seti të komponentëve të rrotës janë gjetur për shkak të të cilave testin provues nuk mund të kryhet, një test i përsëritur duhet të kryhet pas korrigjimit të defekteve apo mangësi të tilla.

8. Për qëllim të marrjes së autorizimit për vendosjen në shërbim të njësisë së mjetit lëvizës, aplikantit duhet të:

8.1. paraqesë një kërkesë dhe dokumentet e mëposhtme të Organi i Sigurisë hekurudhore:

8.1.1. një deklaratë në përputhje me Rregulloren Nr. 201/2011/EU, së bashku me shtojcat e përcaktuara në referuarat-të Rregullores, të aplikuara të një njësi të veçantë e mjeteve lëvizëse;

8.1.2. protokollin për testin provues i përmendur në nenin 10 paragrafi 4 të kësaj Rregullore;

8.1.3. një deklaratë të nënshkruar nga shfrytëzuesi i mjeteve lëvizëse që ka një subjekt përgjegjës për mirëmbajtjen e mjeteve lëvizëse për siç përmendet në ligj, rregulloret për kriteret dhe procedurat për lëshimin, pezullimin dhe revokimin e autorizimit të sigurisë;

8.2. paraqesin njësinë e mjeteve lëvizëse të Organi i Sigurisë hekurudhore, në një kohë dhe vend është rënë dakord më parë.

8.3 Organi i Sigurisë hekurudhore, në përputhje me nenin 10 nën-paragrafin 8.2 të kësaj Rregullore, duhet ftojë përfaqësuesit e përdoruesit dhe menaxherin infrastrukturës hekurudhore

gjatë testimit të njësisë së paraqitur të mjeteve lëvizëse. Në qoftë se nuk ka për qëllim që të përdorë mjetet lëvizëse në infrastrukturën hekurudhore publike, atëherë duhet të ftohen përfaqësues të menaxherit privat infrastrukturës hekurudhore, në infrastrukturën e të cilëve ka për qëllim të përdoren mjetet lëvizëse.

9. Në qoftë se njësia e mjeteve lëvizëse është në përputhje me llojin e mjeteve lëvizëse të vendosura në shërbim, Organi i Sigurisë hekurudhore do ta vendosë në shërbim njësinë e mjeteve lëvizëse në bazë të deklaratës së konformitetit të dorëzuar nga aplikantit lidhur me përshtatshmërinë e mjeteve lëvizëse me këtë lloj (tip) dhe nuk do të kryejë ekzaminime të mëtejshme.

10. Organi i Sigurisë hekurudhore mund të vendosë të jap autorizimin për vendosjen në shërbim të njësisë së mjeteve lëvizëse për çdo njësi të tillë veç e veç ose të marrë një vendim të përbashkët në lidhje me disa njësi identike të mjeteve lëvizëse të të njëjtit lloj.

11. Kur Organi i Sigurisë hekurudhore vendos të refuzojë autorizimin për vendosjen e një njësie të mjeteve lëvizëse në shërbim, do të shpallë vendimin e saj dhe njofton aplikantin.

12. Organi i Sigurisë hekurudhore mund të revokojë vendimin e tij për autorizimin për vendosjen e një njësie të mjeteve lëvizëse në shërbim, duke e shqyrtuar edhe një herë:

12.1. Certifikata e sigurisë e përdoruesit të mjetit lëvizës, në përputhje me ligjet dhe rregulloret për procedurat dhe kriteret për lëshimin, pezullimin ose revokimin e pjesës A dhe pjesës B të një certifikate të sigurisë;

12.2. Autorizimi i sigurisë i përdoruesit të mjetit lëvizës, në përputhje me ligjet dhe rregulloret për procedurat dhe kriteret për lëshimin, pezullimin apo revokimin e lejes së sigurisë.

13. Vendimi nga Organi i Sigurisë hekurudhore për autorizimin për vendosjen në shërbim të një njësie të mjeteve lëvizëse nuk do të ndikojë në përmbushjen e kërkesave për shfrytëzimin e mjeteve të transportit hekurudhor të parashikuara në ligjet dhe rregulloret për procedurat dhe kriteret për lëshimin, pezullimin ose revokimin e pjesës A dhe pjesës B të certifikatës së sigurisë, si dhe në ligjet dhe rregulloret për procedurat dhe kriteret për lëshimin, pezullimin ose revokimin e lejes së sigurisë.

13.1 aplikuesi duhet jetë përgjegjës për shënjimin e mjeteve lëvizëse me një numër të mjeteve të transportit hekurudhor njësisë së dhënë për të.

Neni 11

Rinovimi i Mjetit Lëvizës

1. Me qëllim mirëmbajtjen e kapaciteteve operacionale të mjeteve lëvizëse dhe nivelin e sigurisë së tyre, rinovimi i mjeteve lëvizëse duhet të kryhet siç është parashikuar me inspektimin, riparimin, zëvendësimin, rregullimin dhe ekzaminimet e komponentëve dhe grupeve të mjeteve të transportit hekurudhor . Rinovimi i mjetit lëvizës duhet të mbulojë rinovimin e parametrave bazë të mjeteve të transportit hekurudhor në përputhje me vlerat dhe kërkesat e përcaktuara në dokumentacionin teknik të përmendur në shtojcën 4 të kësaj Rregullore.

2. Rinovimi i mjeteve të transportit hekurudhor, i cili është i autorizuar për vendosjen në shërbim, në përputhje me procedurat e përcaktuara në këtë rregullore, duhet të kryhet në përputhje me programin e rinovimit të përfshira në dokumentacionin teknik të përmendur në shtojcën 4 të kësaj Rregullore, duke ndjekur afatet e rinovimit dhe kryerjen e të gjitha punëve të caktuara.

3. Kur rinovimi është menduar që të përfshijë punët, të cilat nuk janë pjesë e dokumentacionit teknik të përmendur në shtojcën 4 të kësaj Rregullore, as i një programi të mirëmbajtjes dhe riparimi të parashikuar në sistemin e menaxhimit të sigurisë së shfrytëzuesit të mjeteve lëvizëse dhe punë të tilla mund të ndryshojnë parametrat themelore karakteristike të një lloji, siç përmendet në pjesën 6 të shtojcës 2 të kësaj rregullore, njësia ekonomike për kryerjen e rinovimit do të sigurojë që një detyrë e projektimit është hartuar dhe dorëzuar në Organin e Sigurisë hekurudhore për një vendim të përmendur në nenin 1 paragrafi 5 të kësaj Rregullore. Rinovimi i tillë do të konsiderohet si përmirësimin e mjeteve lëvizëse.

4. Kur rinovimi është menduar që të përfshijë punët, të cilat janë përgjegjëse për të ndryshuar parametrat e përgjithshme të përmendura në pjesën 5 të shtojcës 2 të kësaj Rregullore, shfrytëzuesi i mjetet lëvizëse do të kryejë vlerësimin e rrezikut në pajtim me Rregulloren Nr. 402/2013/EU. Shfrytëzuesi i mjeteve lëvizëse hekurudhore do të informojë Organin e Sigurisë mbi rezultatet e vlerësimit të tillë të rrezikut.

